

MOBILIERE RALD

Shoqëria "Erald" sh.p.k

Adresa: Rruga Nacionale Tirane – Fushe Kruje, km 13, ndertese private 1
kateshe, zona kadastrale 3096, me nr. pasurie 97/30

Telefon: 0682065006

Nipt: J74517205P

E-mail: mobilerierald@ymail.com

KONTRATË SHITJE

Sot më datë 23 Shtator 2022 (dymijëenjëzetedy) palët përpiluan këtë kontratë shitje kuotash si më poshtë:

Pala shitëse:

Arta **ULLIRI**, e bija e Ganisë e datëlindjes **02.09.1979**, lindur në Tiranë dhe banuese në Nikël, Krujë i identifikuar me **Nr. ID. 034296818** dhe numër personal identifikimi **H95902021Q** me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Pala Blerëse:

Arjan **MUJA** i biri i Ganisë i datëlindjes 05.05.1973 lindur dhe banues, në Qerekë, Krujë i identifikuar me **Nr. ID. 034332247** dhe numër personal identifikimi **H30501082K** me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

Palët e mësipërme përpiluan këtë kontratë shitje kuotash si më poshtë:

Më datë 28.10.1997 është regjistruar shoqëria "Erald" sh.p.k me seli, Nikël, Qerekë, rruga nacionale Tiranë-Fushë-Krujë, km 13, ndërtesë privatë 1 katëshe, zona kadastrale nr.3096, me numër pasurie 97/30, me objekt veprimtarie "Prodhim dhe tregtim, mobilje të ndryshme, me bazë druri dhe materialeve ndihmëse, prej metali, kombinime dru metal, dyer, dritare prej druri dhe metali, plastikë, veshje, konfeksione, elektroshtepiake, bujqësore, blegtorale, ushqimore, materiale ndërtimi, lëndë drusore, hidrosanitare, përpunim të lëndëve drusore si mobilieri, të të gjitha llojeve për objekte banimi, objekte publike, të sistemit shkollor, administrativ, shëndetsor, punime artistike, makineri dhe pjesë kembimi, vegla auto, pjesëve të këmbimit për automjete dhe makineri, bimëve mjekësore, materialeve elektrike, hidrosanitare, vegla dhe paisje të ndryshme pune, materialeve elektronike, servis, parking, transport te mallrave dhe të udhëtareve, argjendari, tregtim argjendari, bizhuteri, kozmetike, fruta zezavate, plehra kimike, agjensi transporti, taksi, turizëm, prodhime druri, përpunim të drurit si dhe tregtim te artikujve te prodhuar me dru dhe materiale ndihmëse të drurit, përpunim te metalit, tregtim te artikujve te prodhuara prej metali dhe

grumbullim e përpunim të hekurishteve, transport per vehte dhe te tretë. Importimin dhe tregtimin e linjave teknologjike për industrinë ushqimore, të përpunimit të materialeve drusore dhe ato të hidrokarbureve, të përpunimit të lëkurës dhe veshmbathjeve, të aparaturave në fushën e shëndetit dhe trajtimit të medikamenteve mjekësore. Importimin dhe tregtimin e materialeve për përdorim mjekësor si dhe të paisjeve dhe aparaturave për të njëjtin qëllim. Prodhim dyshekësh të përmasave të ndryshme dhe pjesëve ne shërbim te tyre, materiale të imta (çarçafë, batanije, jastëk, rroba pune), rrobaqepësi dhe paisje te tjera te lidhura me to, tregtim me shumicë dhe pakicë të tyre, import-export. Ofrimi i shërbimeve dhe konsulencave profesionale ne fushën e teknologjisë së informacionit: institucioneve publike dhe private, organizatave, SME-ve. Aktivitet në fushën e turizmit, hapje hotelesh, bar-kafe, restorante etj. Shërbim në fushën publike. Shërbime të ndryshme komunale, publike, riparim objektesh dhe shërbime menaxhimi në fushën e shërbimeve publike. Tregtim të paisjeve dhe materialeve të ndryshme të sigurisë personale dhe kolektive”, regjistruar në QKR me Nipt: **J74517205P** me status aktiv me kapital themeltar 35.900.000 (tridhjetëpesëmilionenëntëqindmijë) lekë.

Shoqëria “Erald” sh.p.k ka një ortak:

1. Znj. Arta **ULLIRI** e cila zotëron 100 % të kapitalit me vlerë 35.900.000 (tridhjetëpesëmilionenëntëqindmijë) lekë të ndarë në 35.900 pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë secila.

Me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “Erald” sh.p.k të datës 19.09.2022 është vendosur:

1. Znj. Arta **ULLIRI** e cila zotëron 100 % të kapitalit me vlerë 35.900.000 (tridhjetëpesëmilionenëntëqindmijë) lekë të ndarë në 35.900 pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë secila, ti shesë me anë të kësaj kontratë shitje ti shesë:
2. Z. Arjan **MUJA** 100 % të kapitalit me vlerë 35.900.000 (tridhjetëpesëmilionenëntëqindmijë) lekë të ndarë në 35.900 pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë secila.
3. Blerësi z. Arjan **MUJA** deklaron së është dakord të blejë 100 % të kapitalit me vlerë 35.900.000 (tridhjetëpesëmilionenëntëqindmijë) lekë të ndarë në 35.900 pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë secila.

Palët ranë dakort se me nënshkrimin e kontratës dhe me regjistrimin e kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “Erald” sh.p.k në Qendrën Kombëtarë të Regjistrimit , ortak i vetëm i shoqërisë “Erald” sh.p.k të jetë z. Arjan **MUJA**.

Pala shitëse deklaron se do të jetë përgjegjëse për të gjitha detyrimet që do të lindnin përpara lidhjes së kontratës së mësipërme me person juridik përfshi këtu edhe shtetin, ndërsa për detyrimet që do të rrjedhin pas lidhjes së kontratës përgjegjëse do të jetë pala blerëse.

Kjo kontratë shitje kuotash përpilohet në bazë të nenit 761 e vijues të Kodit Civil, të ligjit nr.9901 datë 14.08.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, I ndryshuar.

Kontrata u përpilua në tre kopje, iu lexua palëve me zë të lartë dhe të qartë, u kuptua prej tyre dhe meqenëse u gjet sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë, nënshkruhet rregullisht sipas ligjit.

Pala Blerëse
Arjan MUJA

Arjan Muya
Arjan Muya

Pala shitëse
Arta ULLIRI

Arta Ulliri

